



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E BRENDSHME

Pukë/SHÇBA arreston 2 punonjës policie, shpërdoruan detyrën e për pasojë u arratis një i ndaluar
2017-09-09 10:43:00

SHÇBA arreston 2 punonjës policie, shpërdoruan detyrën dhe për pasojë u arratis nga Komisariati i Policisë një i ndaluar

Pukë

SHÇBA arreston 2 punonjës policie, shpërdoruan detyrën dhe për pasojë u arratis nga Komisariati i Policisë një i ndaluar

Në vijim të informacionit mbi largimin nga dhomat e shoqërimit të Komisarimit të Policisë Pukë të shtetasit Ermirjon Nikja, SHÇBA ka arrestuar në flagrancë punonjësit e policisë Inspektor Pajtim Bushi dhe Inspektor Dode Preka, me detyrë trupë shërbimi pranë këtij Komisarimit.

Arrestimi i dy punonjësve u bë pas kryerjes së veprimeve hetimore ku u konstatua se nga ana e tyre nuk janë zbatuar detyrat funksionale të përcaktuara për sigurimin e personave të shoqëruar dhe ambjenteve ku ata qëndrojnë.

Të arrestuarit akuzohen për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.